



Universiteti i Prishtinës  
Fakulteti Juridik

# DORACAKU I FAKULTETIT JURIDIK PËR TË DREJTAT E STUDENTËVE

Korrik 2022

Ky doracak është hartuar nga Fakulteti Juridik dhe shërben si orientim për studentët e Fakultetit në mënyrë që ata/ato t'i kuptojnë të drejtat dhe obligimet e tyre që burojnë nga statusi i studentit, të cilin e fitojnë me rastin e regjistrimit në Fakultetin Juridik. Doracaku është hartuar duke u bazuar në Statut dhe rregulloret në fuqi në Universitetin e Prishtinës.

FAKULTETI JURIDIK-UNIVERSITETI I PRISHTINËS

## **Përmbajtja:**

- Fjala e Dekanit
- Hyrje
- Vizioni i Zyrës së Dekanit për studentët
- Pranimi në studime
- Studimet dhe statusi i studentit
- Kohëzgjatja e studimeve
- Humbja e statusit të studentit/es
- Pezullimi i studimeve
- Ndërrimi i drejtimit të studimeve
- Përfundimi i studimeve
- Ligjëratat dhe ushtrimet
- Provimet
- Vlerësimi në provime
- Ankesat lidhur me vlerësimin në provime
- Mobiliteti i studentëve
- Garat e Fakultetit Juridik
- Të drejtat dhe obligimet e studentëve sipas statutit
- Sjelljet etike të studentëve
- Sjelljet e ndaluara dhe shkeljet disiplinore
- Sanksionet për shkelje disiplinore
- E drejta e ankesës
- Shërbimet për studentë në Fakultetin Juridik
- Përfaqësimi studentor në Fakultetin Juridik
- Organizimi i Fakultetit Juridik

## **Shtojcë I:**

**PYETJE TË SHPESHTA NGA STUDENTËT E FAKULTETIT JURIDIK**

## **Shtojcë II:**

**PROGRAMI BAÇELOR-LËNDËT OBLIGATIVE DHE ZGJEDHORE: 2017-2023**

## **Grupi punues që e ka hartuar doracakun:**

**Doracaku për të drejtat e studentëve të Fakultetit Juridik është punuar nga grupi punues (sipas vendimit nr.09/135), datë 18.03.2022, në përbërjen si vijon:**

1. Prof.Ass.Dr.Florent Muçaj-Prodekan për çështje mësimore dhe cilësi
2. Smajl Kuçi-Administrata e Fakultetit Juridik
3. Festim Tasholli-Parlamenti Studentor
4. Lirigzon Hoxha-Parlamenti Studentor
5. Nisa Ferati-Parlamenti Studentor
6. Edona Mushica-Këshilli i Studentëve të Fakultetit Juridik
7. Leotrim Pajaziti-Student i Fakultetit Juridik
8. Lorik Kolshi-Këshilli i Studentëve të Fakultetit Juridik
9. Tringa Goxhufi-Këshilli i Studentëve të Fakultetit Juridik
10. Albin Morina-Student i Fakultetit Juridik
11. Dëborë Jerliu-Studente e Fakultetit Juridik
12. Leonita Jashari-Studente e Fakultetit Juridik
13. Vigan Gërbovci-Student i Fakultetit Juridik
14. Yllza Bedrolli-Studente e Fakultetit Juridik

## Fjala e Dekanit

Të dashur Studentë të Fakultetit Juridik,

Kam kënaqësinë që para jush të prezantojmë **“Doracakun e Fakultetit Juridik për të Drejtat e Studentëve”**, i cili do të jetë një material informues dhe orientues për të gjithë studentët që janë pjesë e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës. Si i tillë, ky doracak në bazë të Vendimit nr.09/135, datë 18.03.2022, është hartuar nga grupi punues, i përbërë kryesisht nga studentët.

Fakulteti Juridik ka për synim primar fuqizimin e rolit të studentëve dhe promovimin e formave të aktivizimit studentor, të përcaktuar si prioritet në Programin qeverisës të Zyrës së Dekanit 2020-2024 (shih ueb faqen e Fakultetit Juridik: <https://juridiku.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,59>), të prezantuar para stafit dhe studentëve me 1 tetor 2020, me rastin e marrjes së mandatit të Dekanit.

Për Fakultetin Juridik dhe Zyrën e Dekanit, përfshirja e studentëve në projekte, grupe punuese dhe vendimmarrje është një vlerë e shtuar, e cila rritë cilësinë dhe kultivon transparencën. Fakulteti Juridik dhe Zyra e Dekanit, në vazhdimësi kanë në fokus kryesor promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të studentëve. Me qëllim të realizimit të kësaj komponente të rëndësishme është hartuar ky doracak, i cili u shërben studentëve të Fakultetit Juridik për t'u informuar rreth të drejtave të tyre si dhe informacioneve të nevojshme për të gjitha çështjet me interes, duke filluar nga momenti i regjistrimit në Fakultetin Juridik deri në momentin e diplomimit.

Aktualisht, Fakulteti Juridik është duke punuar me një dinamikë të lartë në: reformimin e kurrikulës, ri konceptimin e mësimit klinik, funksionalizimin e Qendrës për Studime Klinike bazuar në modelet e universiteteve/fakulteteve juridike më të mira (që do të filloj të funksionoj nga viti i ri akademik), përfshirjen e lëndëve të reja bashkëkohore, zbatimin e programeve të veçanta të certifikimit për studentë dhe pajisjen me ECTS/Kredi shtesë (penale, civile dhe tematikat me aktuale, si: barazia gjinore, mbrojtja nga diskriminimi, mbrojtja nga dhuna në familje, etj.), përfshirja e studentëve në disa programe të praktikës, përfshirja në disa forume ndërkombëtare dhe aktivitete me vlerë për studentët e drejtësisë, pjesëmarrja në garat ndërkombëtare për studentët e drejtësisë (nga ky vit akademik 3 garat me prestigjioze do të jenë pjesë e programit të përhershëm të Fakultetit Juridik), janë themeluar grupet e aktivizimit studentor (Grupi i studentëve të ekselencës, Grupi i debatit, Grupi i garave dhe forumeve ndërkombëtare, etj.), është themeluar edhe Grupi ALUMNI i Fakultetit Juridik, jemi në proces të akreditimit të dy programeve master në gjuhë angleze (njëri në riakreditim), etj. Gjithashtu, nga viti 2020 kemi filluar edhe programin e transformimit të hapësirave të fakultetit juridik, ku prioritet janë ambientet moderne për studentët (një pjesë është përfunduar dhe disa tjera janë në proces të zbatimit).

Të dashur kolegë, studentë të Fakultetit Juridik: kam besimin e plotë se me punën tonë, e mbi të gjitha angazhimin dhe rezultatet tuaja, do të arrijmë që Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës t'a shndërrojmë në një fakultet elitare të drejtësisë, duke i dhënë një perspektivë zhvillimore dhe ndikim në tregun e punës.

Me besimin se ky doracak do të kontribuoj në informimin sa më të mirë për të gjithë studentët, e në funksion të arritjes së rezultateve sa më të larta, ju dëshiroj shumë suksese.

**Sinqerisht,**

**Prof.Ass.Dr. Avni Puka – Dekan i Fakultetit Juridik (UP).**

## **1. Hyrje**

Doracaku i studentëve të Fakultetit Juridik, ka për qëllim që t'i ofroj studentëve të këtij fakulteti të gjitha informacionet e nevojshme për çështjet të cilat atyre u nevojiten nga momenti i regjistrimit dhe deri tek përfundimi i studimeve.

Ky doracak synon të bëjë një përmbledhje të të gjitha aspekteve dhe informacioneve të duhura për të cilat kanë nevojë studentët e Fakultetit Juridik, në mënyrë të përmbledhur.

Hartimi i këtij doracaku ndjek metodologjinë e dhënies së informacioneve të sakta dhe koncize për të gjithë studentët e Fakultetit Juridik.

Doracaku i studentëve është inicuar nga Dekani i Fakultetit Juridik, duke u bazuar në një proces të konsultimit me përfaqësuesit e studentëve si dhe grupet jo formale të studentëve të cilat janë në Fakultetin Juridik. Me qëllim të hartimit të këtij doracaku është krijuar edhe grupi punues (sipas vendimit të Dekanit nr.09/135, datë 18.03.2022) me një përbërje gjithëpërfshirëse, nga studentë përfaqësues nga Parlamenti Studentor, Këshilli i Studentëve të Fakultetit Juridik dhe studentët e Fakultetit nga viti I,II,III dhe IV, Zyra e Dekanit dhe Administrata e Fakultetit Juridik.

Informacionet e dhëna në këtë doracak, janë të bazuara në gjendjen aktuale si dhe infra-strukturën aktuale juridike e cila është në fuqi në Universitetin e Prishtinës. Me rastin e ndryshimit të kësaj infrastrukture doracaku do të përditësohet.

## **2. Vizioni i Zyrës së Dekanit për studentë (Programi 2020-2024):**

Studentët janë arsyeja primare për të cilën ekziston universiteti/fakulteti. Ata nuk janë vetëm një subjekt ndaj të cilit duhet dhënë shërbimi i mësimdhënies, por edhe një pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e fakultetit dhe ndërtimit të kulturës së dijes e debatit për të. Aktivizimi i studentëve për nevoja dhe qëllime të vetë atyre dhe me qëllimin që ata të jenë pjesëmarrës të vërtetë në një komunitet akademik, përbën një praktikë të munguar në Fakultetin Juridik. Angazhimi i tyre megjithatë duhet bërë jo me qëllim të adresimit të një kulture krejtësisht të gabuar për të fuqizuar nevojat e individëve brenda institucionit dhe/apo politikës publike, por për të zhvilluar perspektivën intelektuale e profesionale të vetë studentëve. Një angazhim të tillë duhet bërë në përputhje me parimet e etikës akademike, që nënkupton ndalim të çfarëdo angazhimi studentor për qëllime të politikës së partive, individëve brenda institucionit apo edhe kauzave që në rrejnë nuk përkojnë me qëllimin e edukimit në përgjithësi.

Fakulteti Juridik do të shndërrohet në një hapësirë ku roli i studentit do të fuqizohet maksimalisht, në korniza të një pjesëmarrjeje të shtuar në debate publike, angazhime për punë minimale hulumtuese, projekte kërkimore dhe punë praktike. Studentët më nuk do të jenë një segment i nëpërkëmbur i menaxhimit publik, por një partner për të zhvilluar bashkërisht programe që i afirmojnë debatin mbi dijen, komunikimin publik, karrierën dhe ekselencën në studime dhe punë praktike profesionale. Programi fillimisht parasheh ndërtimin e “Grupeve bërthamë” që do të zhvillojnë programe të aktivizimit të studentëve, e që reflektojnë praktika të ngjashme të universiteteve në vende të zhvilluara. Programe të tilla do të përfshijnë fusha siç janë: debatet e hapura me shkollarë e figura publike në fushat me interes për studentët e drejtësisë, promovimin e lidërshiptit e mendimit kritik, pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare të fushës së ngushtë profesionale, zhvillimin e hulumtimeve dhe publikimin e rezultateve në çështje me interes profesional, zhvillimin e konferencave publike me komponentë të përzier profesional-studentor, zhvillimin në karrierë, etj. Promovimi i rolit të studentëve në komunitetin akademik, në opinionin publik dhe në përgjithësi në media do të jetë theks i veçantë i organizimit të punës në Zyrën e Dekanit, dhe kjo do të shprehet qartësisht edhe në detyrat konkrete të menaxhmentit të fakultetit. Programi ka për qëllim që studentëve të ekselencës tu jepet hapësirë e vërtetë për promovim, zhvillim të lidërshiptit e aftësisë për fjalime publike dhe për ndërtim kauzash që përkohet me qëllimet e nxënies së dijes dhe formimit cilësor për juristët e së ardhmes.

### 3. Pranimi në studime

Statusin e studentit e kanë të gjithë ata/ato të cilët regjistrohen në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Personi i/e cili/a arrin të regjistrohet në Fakultetin Juridik e fiton statusin e studentit. Statusi i studentit dëshmohet me indeks ose ID kartelë elektronike të studentëve.

Pranimi në studime në Fakultetin Juridik bëhet përmes konkursit publik. Senati i Universitetit të Prishtinës i cakton kriteret për pranimin e studentëve të Fakultetit Juridik. Numri i studentëve të rinj në Fakultetin Juridik propozohet nga Këshilli i Fakultetit Juridik. Numri i studentëve caktohet nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).

Konkursi për pranimin e studentëve në Fakultetin Juridik (studimet themelore) hapet një ose dy herë në vit (**përkatësisht në periudhën qershor/korrik dhe eventualisht në shtator**), varësisht nga vendimi i Senatit të Universitetit të Prishtinës. Konkursi për pranimin e studentëve është i hapur 15 ditë.

Të gjithë aplikantët në konkurs për pranimin në studime në Fakultetin Juridik, i nënshtrohen provimit pranues në lëndët profesionale. Për pranim në nivelin e studimeve themelore aplikantët për të fituar statusin e studentit i nënshtrohen provimit pranues në lëndët: **E Drejta Kushtetuese, Fillet e së Drejtës dhe Gjuhë Shqipe.**

Kandidatët të cilët aplikojnë për pranim në studimet master i nënshtrohen provimit në lëndët profesionale, varësisht nga programi i studimeve, duke u bazuar në kriteret e konkursit publik.

Konkursi për pranimin e studentëve menaxhohet nga komisioni përkatës për menaxhimin e konkursit i cili themelohet nga Këshilli i Fakultetit Juridik.

Rezultatet e provimit pranues shpallen sipas afateve që përcaktohen në konkursin publik. Konsiderohen të pranuar të gjithë kandidatët, të cilët kanë arritur pragun e mjaftueshëm të pikëve, sipas renditjes në listën e shpallur nga Fakulteti Juridik.

Lidhur me rezultatin e provimit pranues, kandidatët kanë të drejtë ankese në një afat të caktuar, sipas shpalljes (njoftimit) të cilën e bën Fakulteti Juridik, respektivisht 48 orë pas shpalljes së rezultateve preliminare.

Të pranuarit sipas konkursit për pranimin e studentëve fitojnë statusin e studentit, pasi të jenë regjistruar, sipas afatit dhe njoftimit të cilin e bën Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti Juridik.

Studentët në studime Master pranohen mbi bazën e konkurrimit, sipas rezultateve të studimeve paraprake dhe ekuivalencës së tyre sikurse përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë. Kriteret e posaçme për pranim në studimet Master do të caktohen nga Senati në përputhje me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës.

Studenti/ja pas marrjes së rezultateve përfundimtare të provimit pranues dhe arritjes së pikëve të nevojshme për tu pranuar në Fakultetin Juridik duhet të regjistrohet në Administratën Qendrore të UP-së si dhe fotografohet, me qëllim të prodhimit të ID kartelës së tij/saj.

Me rastin e pranimit, studenti/ja i/e cili/a është pranuar në studime regjistrohet në **“Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Studentëve” (SEMS)**, me ç’rast i krijohet llogaria e tij/saj, në të cilën ai/ajo ka qasje gjatë gjithë kohës së studimeve.

#### **4. Studimet dhe statusi i studentit**

Studimet themelore në Fakultetin Juridik, sipas programit të akredituar zgjasin katër (4) vite respektivisht tetë (8) semestra. Sipas programit të studimeve (2017-2023), përgjatë një semestri, gjatë studimeve, studentët zgjedhin katër lëndë obligative dhe një lëndë zgjedhore. Studimet themelore janë të akredituara në vetëm një program (drejtim). Në semestrin e fundit (VIII) të studimeve themelore bëhet ndarja në module, me ç’rast programi i akredituar ka këto module: Moduli Penal; Moduli Civil; Moduli Kushtetues-Administrativ; Moduli Ndërkombëtar dhe Moduli Financiar.

Studimet Master në Fakultetin Juridik zgjasin dy semestra, përfshirë edhe tezën e Masterit, e cila procedohet dhe mbrohet sipas rregulloreve në fuqi për studimet Master. Studimet Master përfundojnë me mbrojtjen e tezës së Masterit.

Studimet Master janë të akredituara në disa programe:

- 1) Programi: E Drejta Penale;
- 2) Programi E Drejta Civile dhe Pronësore;
- 3) Programi: E Drejta Kushtetuese dhe Administrative;
- 4) Programi: E Drejta Ndërkombëtare
- 5) Programi: Kontratat dhe E Drejta Komerciale;
- 6) Programi: E Drejta Financiare;
- 7) Programi: Studime të Avancuara Evropiane (gjuhë angleze);

Studimet e doktoratës në Fakultetin Juridik zgjasin tri (3) vite, respektivisht gjashtë (6) semestra. Studimet e doktoratës përfundojnë me mbrojtjen e tezës së doktoratës.

#### **4.1. Kohëzgjatja e studimeve**

Përfundimi me sukses i vitit në pajtim me programin e studimit është parakusht që studenti/ja të regjistrohet në vitin tjetër.

Studenti/ja i cili nuk ka mundur të përfundojë me sukses vitin duhet sërish të regjistrohet në vitin e njëjtë të studimeve. Numri maksimal i viteve të regjistruara sërish është i barabartë me numrin e viteve të rregullta të studimit përkatës (**Sqarim: Kjo nënkupton se nëse janë 4 vite të rregullta, studenti mund të regjistroj maksimalisht 8 vite**).

Studenti/ja i Fakultetit Juridik mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një apo dy (2) vite. Vendimin e merr Këshilli i Fakultetit Juridik. Në rast se merret vendim pozitiv studenti/ja do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.

Këshilli i Fakultetit Juridik zbaton rregullat e posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt (edhe më gjatë sesa dyfishi i studimeve) në këto raste:

1. Për të arriturat e veçanta në fushën e sportit, vërtetuar me status amator apo profesional në nivel rajonal apo më lart (në rastin e Fakultetit Juridik, nëse ka sportistë të suksesshëm);
2. Për individët me aftësi të kufizuar fizike, duke përfshirë edhe aftësitë e kufizuara të të paritë dhe të dëgjuarit, apo mendore, vërtetuar me certifikatë të mjekut.



Në rastet e studimeve Master, në Fakultetin Juridik, statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy (2) viteve pasi të jenë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studenti duhet të mbrojë me sukses temën e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.

Studenti/ja që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën (2 vite), mund të paraqesë kërkesë te dekani i Fakultetit Juridik për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një (1) vit.

Mënyra e zgjedhjes së temave në studimet Master është e përcaktuar me vendim të Këshillit të Fakultetit Juridik, i nxjerrë në qershor 2021. Sipas këtij vendimi Profesorët e lëndëve në programet Master do të publikojnë listën e temave dhe studentët duhet të zgjedhin temat, duke u bazuar në atë listë. Studentët pasi të jenë përcaktuar për temën përkatëse në kuadër të listës, duhet të kontaktojnë zyrtarisht profesorin për të ndjekur procedurat përkitazi me miratimin e propozimit të temës në katedrën përkatëse si dhe në Këshillin e Fakultetit Juridik.

#### **4.2. Humbja e statusit të studentit/es**

Studenti i rregullt i Fakultetit Juridik humb statusin për këto arsye:

1. Kur vendos të largohet nga studimet;
2. Kur i ka përfunduar studimet;
3. Kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;
4. Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve;
5. Kur arrin numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet.
6. Në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore.

#### **4.3. Pezullimi i studimeve**

Studenti/ja i Fakultetit Juridik mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si të:

1. Sëmundjes së rëndë;
2. Kujdesi për fëmijët nën moshën tri vjeçare;
3. Shtatzënisë dhe lehonisë;
4. Tjera të justifikuar.

Vendimin përfundimtar për pezullimin e studimeve e merr Dekani i Fakultetit Juridik, pas kërkesës së studentit/es përkitazi me pezullimin e studimeve.

#### **4.4. Ndërrimi i drejtimit të studimeve**

Studenti/ja mund të bëjë ndërrimin e programit të studimit duke përfunduar mësimin në një program të studimit dhe duke filluar mësimin në një program tjetër të studimit në Fakultetin Juridik apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit të Prishtinës.

Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit. Gjatë ndërrimit të programit të studimit, studentit i lejohej legalisht të fillojë programin e ri të studimit nëse së paku 50% e provimeve janë dhënë me sukses, gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.

Studentit i lejohej të regjistrohet në programin e ri të studimeve: Më së paku në vitin e dytë të studimeve ose në vitin e studimeve që vijon pas programit të vjetër të studimeve.

Ndërrimi i programit të studimit nuk mund të bëhet nëse student/ja duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve, në programin e ri të studimeve.

Në studimet themelore në Fakultetin Juridik nuk mund të bëhet kërkesë për ndërrimin e programit pasi që ekziston vetëm një program i akredituar.

#### **4.5. Përfundimi i studimeve**

Përfundimi i studimeve në nivelin e studimeve themelore në Fakultetin Juridik, sipas programit të akredituar bëhet pas përfundimit të provimit të fundit.

Përfundimi i studimeve Master në Fakultetin Juridik bëhet me mbrojtjen e tezës së Masterit, me ç'rast student/ja fiton titullin shkencor "Master i shkencave juridike në drejtimin përkatës"

Përfundimi i studimeve të doktoratës në Fakultetin Juridik bëhet me përfundimin dhe mbrojtjen me sukses të disertacionit të doktoratës, me ç'rast doktoranti fiton titullin "Doktor i shkencave juridike në programin përkatës".

Pas përfundimit të provimit të fundit në studime themelore student/ja parashtron kërkesën për pajisje me diplomë dhe fillimin e procedurave të diplomimit. Administrata e Fakultetit Juridik shqyrton kërkesën dhe i jep të gjitha informacionet e nevojshme për çështjen e diplomimit të studentit/es.

## 5. Ligjëratat dhe ushtrimet

Sipas programit të akredituar, mësimi në Fakultetin Juridik realizohet përmes ligjëratave teorike dhe ushtrimeve. Në kuadër të ligjëratave dhe ushtrimeve përfshihet edhe pjesa e lëndëve klinike që janë në kuadër të programit.

Ligjëratat mbahen sipas orarit të shpallur paraprakisht nga ana e Fakultetit Juridik. Orari shpallet publikisht para fillimit të vitit akademik.

Viti akademik në Fakultetin Juridik fillon me 1 Tetor dhe përfundon me 30 shtator të vitit përkatës. Semestri dimëror fillon me 1 Tetor dhe përfundon me 15 janar. Semestri veror fillon me 16 shkurt dhe përfundon me 30 maj.

Ligjëratat dhe ushtrimet mbahen duke u bazuar në orarin e shpallur, ku përcaktohet koha dhe vendi (salla) e mbajtjes së ligjëratave/ushtrimeve. Ligjëratat mbahen nga Profesorët (bartësit) e lëndëve ose nga asistentët e autorizuar kurse ushtrimet mbahen nga asistentët e lëndës. Ligjëratat realizohen në bazë të syllabusit të akredituar në lëndën përkatëse.

Me qëllim të fitimit të drejtës për t'ju nënshtruar provimit, studentët duhet t'i ndjekin ligjëratat të parapara në syllabusin e lëndës të paktën 70%.

Pjesëmarrja në ligjëratat evidentohet përmes sistemit elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS) dhe listave fizike. Studentët me rastin e fillimit të ligjëratës duhet të bëjnë hyrjen dhe daljen nga salla përmes ID kartelës në pajisjen e evidentimit që është e vendosur në sallë dhe e cila është e integruar në SEMS.

## 6. Provimet

Provimet mbahen në tri (3) afate të rregullta që përcaktohen me statut dhe atë: **Afatin e Janarit, Qershorit dhe atë të Shtatorit.**

Përveç provimeve, profesorët e lëndëve sipas syllabusit dhe programit të akredituar mbajnë edhe provime mes semestrave (kollokfume). Lidhur me mbajtjen e provimeve mes semestrave studentët do të njoftohen nga profesorët e lëndëve dhe të njëjtat mbahen në javën e shtatë (7) ose të tetë (8), sipas syllabusit të lëndës përkatëse.

Orari i provimeve shpallet nga Fakulteti Juridik, para fillimit të secilit afat të provimeve. Në afatin e provimeve shënohet data e mbajtjes së provimit përkatës. Orari i provimit i shpallur nga Fakulteti Juridik është obligativ për profesorin dhe studentët. Orari i provimeve mund të shpallet edhe për tërë vitin akademik përkatës, në mënyrë që studentët dhe personeli akademik të planifikojnë agjendën e realizimit të provimeve.

Orari i provimeve do të përcaktohet në atë mënyrë që të mos ketë më shumë se një provim brenda ditës.

Provimet mund të mbahen në tri mënyra:

- 1) Me shkrim;
- 2) Me gojë dhe
- 3) Në mënyrë të kombinuar (me shkrim dhe me gojë).

Provimet mund të mbahen edhe me një komision për provime, në rast se studenti është ankuar dhe nëse në atë mënyrë është paraparë me program të studimeve përkatëse.

Procedura e mbajtjes së provimeve është e përcaktuar në programin e studimit. Mënyra e përcaktimit të dijës dhe dhënies së provimit përcaktohet në programin e lëndës përkatëse (syllabusin e lëndës).

Në të gjitha rastet kur studenti mungon ose tërhiqet nga provimi, konsiderohet se ka dështuar dhe notohet me notën 5.

Studenti/ja i pakënaqur me rezultatin e provimit, përveç të drejtës së ankesës ka mundësi të kërkoj sqarime nga bartësi i lëndës lidhur me rezultatin.

Me kërkesë të studentit Dekani mund të lejojë që ai/ajo t'i nënshtrohet më herët provimit. Kusht për t'u realizuar një kërkesë e tillë është që studenti/ja të dëshmojë se ai/ajo do të marrë pjesë në një program mobiliteti ndërkombëtar, aktivitet tjetër ndërkombëtar gjatë periudhës në të cilën është përcaktuar që të mbahet provimi.

Paraqitja e provimeve bëhet sipas njoftimit të shpallur nga Fakulteti Juridik. Paraqitja e provimit bëhet përmes programit “Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Studentëve” (SEMS), përmes llogarisë së studentit.

Studenti/ja nuk mund t'i paraqesë provimet e vitit përkatës pa e përfunduar vitin paraprak. Studenti mund t'i dëgjojë ligjëratat e vitit përkatës, nëse ka fituar kushtin e përcaktuar dhe ka dhënë numrin e mjaftueshëm të provimeve në vitin përkatës. Për shembull studenti/ja i vitit të parë, mund t'i dëgjojë ligjëratat e vitit të dytë nëse ka dhënë 50% të provimeve të vitit të parë, mirëpo munk mund t'i paraqesë provimet e vitit të dytë pa i kaluar të gjitha provimet e vitit të parë. Ky rregull vlen pa përjashtim për të gjitha vitet.

## 7. Vlerësimi në provime

Vlerësimi në provime bëhet nga pyetësi, respektivisht profesori i lëndës tek i cili studenti/ja e ka paraqitur provimin, duke pasur parasysh syllabusin e lëndës. Pas përfundimit të provimit, rezultatet e vlerësimit të studentëve shpallen publikisht.

Me rastin e publikimit të rezultateve të provimit, profesori i lëndës në njoftimin për shpallje të rezultateve mund të njoftojë studentët edhe për sqarime të tjera rreth provimit.

Studentit/es, në bazë të rezultatit të provimit i përshkruhet nota në SEMS. Nga momenti i përshkimit të notës në SEMS, studenti ka mundësi t'a pranojë ose t'a refuzojë notën me të cilën është vlerësuar, brenda afatit 72 orësh nga momenti i vendosjes së notës. Refuzimi ose mos refuzimi i notës është përgjegjësi e studentit/es.

Për përcaktimin e suksesit akademik do të aplikohen këto metoda:

1. Provimi;
2. Kolokviumi;
3. Punimi seminarik;
4. Praktika profesionale;
5. Testi praktik gjatë ushtrimeve;
6. Interpretimi dhe prezantimi i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera.

Fakulteti Juridik zbaton këto nota për të përshkruar nivelin e suksesit në provime:

1. 10 dhe 9 (shkëlqyeshëm)
2. 8 (shume mirë)
3. 7 (mirë)
4. 6 ( mjaftueshëm)
5. 5 (pamjaftueshëm)

Studenti/ja kalon provimin me sukses me notat 6 – 10.

Rezultatet e provimeve shpallen në SEMS por edhe në web faqen e Fakultetit në një periudhë të arsyeshme, më së largu 15 ditë nga dita e mbajtjes së provimit.

## 8. Ankesat lidhur me vlerësimin në provime

Studenti/ja ka të drejtë të parashtrij ankesë me shkrim dekanit të Fakultetit Juridik kundër notës së marrë në provim. Ankesa duhet të parashtrihet brenda dy (2) ditëve të punës pasi të jenë shpallur rezultatet e provimit.

Pas pranimit me kohë të ankesës, dekani i njësisë akademike formon komisionin e provimit brenda një dite të punës pasi të jetë pranuar ankesa dhe emëron tre anëtarë, por pa pyetësin kundër notës së të cilit është ankuar studenti.

Në rast se përsëritet provimi me gojë, vlerësimi nga komisioni bëhet në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.

Në rast të ankesës kundër notës në provimin me shkrim, provimi me shkrim do të rishqyrtohet nga komisioni në ditën vijuese të punës pasi të jetë caktuar komisioni.

Nuk mund të parashtrihet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

Testet nga provimet lidhur me vlerësimin e studentëve ruhen se paku një (1) vit. Studenti/ja ka të drejtë të riprovohet në lëndën të cilën nuk e ka dhënë.

Studenti ka të drejtë të hyjë më së shumti tri (3) herë në provimin të cilin nuk e ka dhënë (provim që nuk e ka dhënë nënkuptohen rastet e notimit me notën 5).

Studentit pasi të ankohet, me një arsyetim të fortë, mund t'i lejohet nga dekani i Fakultetit Juridik që të hyjë në provim për të katërtën (4) herë. Provimi pastaj mund të mbahet para komisionit prej tre anëtarësh të cilët janë të emëruar nga dekani i njësisë akademike.

Në rast se studenti sërish e regjistron vitin e njëjtë, nuk merret parasysh numri i mëparshëm i provimeve të dështuara të studentit.

Në rast se studenti sërish dështon 4 herë në provim gjatë vitit të përsëritur, ai humb statusin e studentit të rregullt për nivelin e studimeve.

Studenti/ja mund të riftojë statusin e studentit në qoftë se paraqitet në një program të ri të studimeve. Vendimi mbi ri-fitimin e statusit të studentit përcakton provimet që i pranohen studentit si dhe obligimet tjera të studentit në programin e ri të studimeve.

## 9. Mobiliteti i studentëve

Studentët e Fakultetit Juridik kanë mundësi të zhvillojnë mobilitet brenda dhe jashtë Universitetit të Prishtinës.

Mobiliteti i studentëve jashtë Universitetit të Prishtinës bëhet përmes marrëveshjeve me universitetet e tjera në kuadër të programeve ERASMUS si dhe programeve tjera eventuale që ka Universiteti i Prishtinës. Për t'u realizuar mobiliteti i studentit/es duhet të nënshkruhet marrëveshja e mësimit (Learning Agreement) në mes të Fakultetit Juridik dhe personit përgjegjës të Universitetit/Fakultetit Juridik ku studenti/ja e zhvillon mobilitetin.

Në pajtim me programin e studimeve studenti i Fakultetit Juridik mund të zgjedh dhe të regjistroj lëndë të caktuara në njësitë tjera akademike të universitetit në qoftë se lënda e zgjedhur nuk zhvillohet në fakultetin ku është i regjistruar studenti/ja.

Regjistrimi i lëndës mund të bëhet me lejen e Fakultetit Juridik dhe me pajtimin e njësisë akademike ku studenti e regjistron lëndën.

Me rastin e lejimit, studentit i jepet vërtetimi mbi lejimin për regjistrim të lëndës së caktuar dhe lartësia e ECTS kredive që do të fitohen me përfundimin e lëndës. ECTS kreditë e fituara do t'i llogariten në programin e studimeve të studentit.

Në dokumentin zyrtar të studentit shënohen të dhënat për lëndën e regjistruar, përmeshja e obligimeve të studentit dhe suktesi i treguar. Për ECTS kreditë e fituara studentit i lëshohet dëshmi nga njësia akademike ku studenti i ka fituar ato.

Njoftimet përkitazi me mobilitetin akademik shpallen në web faqen e Fakultetit Juridik.

### 9.1. Garat ndërkombëtare për studentët e Fakultetit Juridik

Garat ndërkombëtare për studentët e drejtësisë si pjesë e programit të përhershëm të Fakultetit Juridik jenë:

- **JESSUP International Moot Court, Washington D.C. (Shtetet e Bashkuara të Amerikës);**
- **ICC Moot Court Competiton , Hagë (Mbretëria e Holandës);**
- **Willem C. Vis International Arbitration Moot Court, Vjenë (Austri).**

Këto gara zhvillohen nën kujdesin e profesorëve (bartësve) të lëndëve përkatëse nga fusha në të cilën zhvillohen këto gara, në koordinim me menaxhmentin e Fakultetit Juridik.

Në koordinim me profesorin (bartësin) e lëndës që udhëheq përgatitjet për gara, menaxhmenti mund të angazhoj trajnerë (përfshirë edhe studentët që paraprakisht kanë marrë pjesë në këto gara) dhe ekspertë që ndihmojnë në përgatitjen e ekipit të studentëve që përfaqësojnë Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës.

Studentët që kualifikohen për pjesëmarrje në këto gara janë edhe pjesë e Grupit të Studentëve të Ekselencës së Fakultetit Juridik.

Garat/forumet/konferencat e tjera ndërkombëtare ku përfaqësohen studentët e Fakultetit Juridik janë edhe:

- Nuremberg Moot Court, Nurmberg, Gjermani;
- Gara Harvard Model United Nations (HMNUN), ShBA;
- Gara ndërkombëtare në të "Drejtën Humanitare" në Lubjanë të Sllovenisë;
- Simpoziumet e Institutit Universitar të Evropës dhe Universitetit James Madi son në Firencë të Italisë, Etj.

Nga viti 2022 disa nga garat ndërkombëtare me prestigjioze për studentët e drejtësisë janë bërë edhe pjesë e programit të përhershëm të Fakultetit Juridik-UP, të cilat është propozuar të jenë edhe pjesë e Programit të ri të studimeve themelore - Baçelor.

## **10. Të drejtat dhe obligimet e studentëve sipas statutit**

Studentët që janë të pranuar në Fakultetin Juridik kanë të drejtë:

1. Të marrin pjesë në të gjitha ligjëratat, seminarët dhe në mësimet e organizuara në lëndët e programit të zgjedhur të studimit sipas mbarëvajtjes së studimeve.
2. Të shfrytëzojnë bibliotekat universitare dhe shërbimet tjera për studentë.
3. Të marrin pjesë në zgjedhjet për përfaqësuesit studentë në organet universitare, të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe në mënyrë të sinqertë. Në rast të konfliktit të interesit në lidhje me përmbajtjen, anëtarët e deleguar të studentëve nuk marrin pjesë në takime të organeve qeverisëse të Universitetit.



Studentët gëzojnë të drejtën për të paraqitur ide të reja dhe opinione të debatueshme pa rrezikuar humbjen e vendit të studentit ose privilegjet që mund të gëzojnë nga universiteti.

Studentët kanë të drejtë të ankohen lidhur me cilësinë e procesit të mësimdhënies ose për infrastrukturën e universitetit.

Studentët gëzojnë të drejtën për të kundërshtuar një vendim apo një veprim të Universitetit ndaj tyre në Ministri dhe në gjykatën kompetente.

Studentët që janë të pranuar në Fakultetin Juridik kanë obligim:

1. T'i respektojnë rregulloret e lëshuara nga Universiteti;
2. T'i respektojnë të drejtat e personelit dhe të studentëve të tjerë;
3. T'u kushtojnë vëmendje të duhur studimeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitetet akademike;
4. Të vijnë ligjëratat në pajtim me rregullat e programit specifik të studimeve;
5. Të sillen mirë si në lokalet e Universitetit, ashtu edhe jashtë tyre për të mos e diskredituar Universitetin;
6. Të respektojnë rregullat e kodit etik;
7. Të paguajnë pagesa dhe tarifa që janë të caktuara.

### **11. Sjelljet etike të studentëve**

Të gjithë studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës e kanë obligim që të respektojnë kodin etik në fuqi.

Universiteti i Prishtinës, me qëllim të rregullimit të çështjeve etike për studentët ka miratuar **rregullore për procedurën dhe masat disiplinore të studentëve**. Kjo rregullore vlen edhe për studentët e Fakultetit Juridik dhe e njëjta zbatohet nga komisioni disiplinor përkatës, i cili krijohet nga ana e Fakultetit.

### **12. Sjelljet e ndaluara dhe shkeljet disiplinore**

Rregullorja për procedurat dhe masat disiplinore për studentë përcakton shkeljet disiplinore të cilat mund t'i bëjnë studentët e Fakultetit Juridik, por edhe të fakulteteve tjera në kuadër të Universitetit. Shkeljet disiplinore kategorizohen në shkelje të lehta dhe shkelje të rënda.

Shkelje të lehta disiplinore konsiderohen:

1. Sjellja e pahijshme dhe jo e mirë në objektet e fakultetit/universitetit, ku mbahen ligjëratat, ushtrimet, provimet, punët administrative dhe aktivitetet e tjera;
2. Prishja e rendit dhe qetësisë gjatë ligjëratave dhe pengimi i punës normale të mësimdhënësve dhe studentëve gjatë ligjëratës;
3. Shkatërrimi i qëllimshëm i pajisjeve mësimore, kompjuterëve, fondit të librave në bibliotekë dhe pronës së Fakultetit Juridik;
4. Pjesëmarrje në tubime, brenda hapësirës së Universitetit dhe Fakultetit për të cilat nuk ka leje;
5. Kryerja e aktiviteteve tjera me të cilat shkaktohet dëm dhe cenohet autoriteti i Universitetit, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve, punëtorëve të tjerë dhe studentëve të fakultetit.

Shkelje të rënda disiplinore konsiderohen:

1. Dhënia e shënimeve jo të sakta organeve të Universitetit, me qëllim të përvetësimit të të drejtave të caktuara;
2. Tjetërsimi ose përmirësimi në dokumentet e shënimeve nga dokumentet e lëshuara nga Universitetit;
3. Nxitja dhe/ose pjesëmarrja në incidente në objektet e Universitetit ku pengohet zhvillimi i proceseve akademike, administrative dhe proceseve tjera;
4. Shkatërrimi dhe dëmtimi me qëllim i pasurisë së Universitetit, përfshirë infrastrukturën, pajisjet dhe inventarin;
5. Nxitja dhe përfshirja në sjellje abuzive ndaj personelit akademik, administrativ, studentëve dhe palëve tjera që gravitojnë në Universitet. Sjellja abuzive është çdo formë apo përpjekje për të ushtruar dhunë fizike ndaj të tjerëve, kërcënimet, komentet dhe ofendimet rreth orientimit seksual, moshës, nevojave të veçanta (paaftësisë), religjionit, përkatësisë etnike;
6. Përdorimi dhe/ose posedimi i alkoholit, drogës dhe substancave tjera të paljuara në objektet e universitetit, si dhe frekuentimi i universitetit në gjendje të dehur, droguar, manifestuar me sjellje agresive;
7. Ndalimi ose pengimi i organizimit të procesit mësimor (ligjëratat, ushtrime, kollokfume, provime dhe lloje tjera të mësimit dhe vlerësimit);
8. Përçarje, ndërhyrje ose pengim i veprimtarive akademike, administrative, sportive, sociale, kulturore ose aktiviteteve të tjera të Universitetit;
9. Përdorimi ose posedimi i mjeteve të palejuara në provime, kollokfume ose formave tjera të vlerësimit, si për shembull, përdorimi i paautorizuar i telefonit, kalkulatorit, librave, kopjeve të ndryshme e të ngjashme;
10. Kopjimi apo tentimi për të kopjuar gjatë provimeve, kollokfumeve, testeve ose formave tjera të vlerësimit;
11. Keqpërdorimi virtual i provimit dhe shpërndarja e testeve në rrjete sociale;

12. Hyrja në kollokfume, provime, teste apo forma tjera të vlerësimit, në emër të dikujt tjetër si dhe përgatitja e punimit të diplomës, seminareve dhe detyrave për studentë të tjerë;
13. Huazimi apo dhënia në shfrytëzim e ID kartelës, passwordit të emailit të uni versitetit, dhe mjeteve tjera identifikuese, studentëve apo personave tjerë fizik;
14. Përdorimi i paautorizuar i mjeteve dhe resurseve të universitetit;
15. Fotokopjimi, fotografimi, inqizimi dhe shpërndarja e paautorizuar e orës mësi more, materialit për përgatitje të provimit dhe afatit të provimeve, testeve etj;
16. Dorëzimi në vlerësim i punimeve, seminareve, projekteve dhe detyrave me plagjiaturë;
17. Dorëzimi në vlerësim i punimeve, prezentimeve, projekteve hulumtuese me rezultate të falsifikuara/të sajuara;
18. Fshehja dhe ndihma studentëve tjerë në kryerjen e shkeljes disiplinore;
19. Çdo veprim ose mosveprim që sjell ose ka potencial për t'a sjellë Universitetin ose partnerët e tij në mos respekt, ose që dëmtojnë ose kanë potencialin të dëmtojnë marrëdhëniet e universitetit me komunitetet e tij;
20. Çdo shkelje sipas marrëveshjeve, kodeve, kontratave, vendimeve, politikave dhe procedurave të tjera të Universitetit;
21. Çdo sjellje që çon në një hetim penal ose që përbën një vepër penale;
22. Mosrespektimi i ndonjë kërkese ose ndëshkimi të vendosur më parë sipas këtyre rregulloreve.
23. Veprime ose mosveprime që kërcënojnë shëndetin ose sigurinë e studentëve dhe stafit;
24. Aktivitete të tjera të cilat nuk janë përmendur në këtë rregullore, por konsid erohen si shkelje me aktet tjera të aprovuara në nivel fakulteti dhe universiteti;
25. Secili veprim që fyen rëndë integritetin e Fakultetit/Universitetit, personelit ak ademik dhe jo akademik;
26. Presioni ndaj personelit akademik me qëllim të ndikimit në procedurat e vlerësimit dhe paraqitja (denoncimi) i rrejshëm fakteve ndaj personelit akade mik apo administrativ;
27. Përdorimi i paautorizuar i emrit, logos së Fakultetit apo Universitetit, përf shirë hapjen e paautorizuar të llogarive në rrjete sociale në emër të organeve të UP-së;
28. Reagime të paautorizuara në rrjete sociale në emër të organeve të UP-së, përf shirë edhe reagimin e paautorizuar në emër të përfaqësuesve të studentëve;
29. Shkrimi dhe reagimi në rrjetet sociale dhe aplikacionet (viber, whatsaap dhe të ngjashme) në mënyrën që cenon integritetin dhe privatësinë e personelit akademik, administrativ apo studentëve.

Raportimi i shkeljes disiplinore bëhet nga personeli akademik, secili student apo nga një palë tjetër e përfshirë që ka dijeni dhe i/e cili mendon që studenti/ja që duhet të raportohet ka bërë shkelje disiplinore.

Shkelja disiplinore raportohet në komisionin disiplinor të Fakultetit Juridik.

Komisioni disiplinor i Fakultetit Juridik, pas zhvillimit të procedurës, nxjerr vendim për shqiptimin e masës disiplinore lidhur me shkeljen disiplinore e cila ka ndodhur.

### **13. Sanksionet për shkelje disiplinore**

Për shkeljet disiplinore të cilat mund t'i bëjnë studentët në Fakultetin Juridik sanksionohen ashtu siç është e përcaktuar me rregullore.

Sanksionet ndaj studentëve, për shkelje të lehta disiplinore janë:

1. Paralajmërimi verbal për masa të tjera;
2. Kërkesë për të paraqitur kërkim falje;
3. Vendim për të paguar çdo dëmtim ose tarifë për dëmin material;
4. Vërejtje me shkrim.

Sanksionet ndaj studentëve për shkelje të rënda disiplinore janë:

1. Vendim për të paguar çdo dëmtim ose tarifë për dëmin material të shkaktuar;
2. Vendim për të kryer punë në komunitet siç është angazhimi në organizimin e aktiviteteve të ndryshme edukative nga ana e Universitetit dhe partnerëve të tij;
3. Ndalesë në hyrje në provime, në një apo më shumë afate të provimeve;
4. Ndalim i përkohshëm (suspendim) nga fakulteti për 6 muaj;
5. Ndalim i përkohshëm (suspendim) nga fakulteti për 1 vjet;
6. Përgjithmonë nga fakulteti dhe Universiteti;
7. Humbja e të drejtës për të gëzuar përkrahje financiare nga Universiteti siç është bursa universitare apo grante të ndryshme që fitohen në emër të Universitetit.

Në rast se studenti/ja suspendohet përkohësisht nga Fakulteti Juridik periudha e suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt, nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.

Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit pas suspendimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt, komisioni i studimeve i njësisë akademike vendos për provimet diferenciale ose për obligimet tjera shtesë si kusht për vazhdimin e studimeve.

## **14. E drejta e ankesës**

Studentët e Fakultetit Juridik kanë të drejtë të ankohen kundër vendimit të marrë prej organeve të Universitetit, të Fakultetit dhe njësisë organizative që kanë të bëjnë me të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.

Ankesat e tilla i dorëzohen **komisionit të studimeve të Fakultetit Juridik brenda 15 ditëve të punës pas shpalljes së vendimit.**

Komisioni i studimeve është i obliguar t'ia dorëzojë raportin për vendimin e marrë këshillit të njësisë akademike brenda 45 ditëve të punës pas pranimit të ankesës.

Ankesa rreth vendimit në shkallë të dytë vendoset nga Senati. Studentët po ashtu kanë të drejtë të kundërshtojnë vendimin e Senatit në gjykatën kompetente.

## **15. Shërbimet për studentë në Fakultetin Juridik**

Administrata e Fakultetit Juridik e cila është e përbërë nga zyrtarët e shërbimit të studentëve në studimet themelore, Master dhe të doktoratës ofron shërbime, sipas nevojave që kanë studentët.

Studentët e Fakultetit Juridik mund të kryejnë shërbime të ndryshme në administratë që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e studimeve, provimeve dhe çështje të tjera që burojnë nga statusi i studentit.

## **16. Përfaqësimi studentor në Fakultetin Juridik**

Studentët e Fakultetit Juridik i kanë përfaqësuesit e tyre të zgjedhur me votë, përmes zgjedhjeve të lira studentore të cilat mbahen çdo dy vjet.

Studentët e Fakultetit Juridik i përfaqëson Këshilli i Studentëve të Fakultetit Juridik, që përbëhet nga 21 anëtarë studentë të cilët zgjedhen me votat e studentëve, në zgjedhjet studentore.

Këshilli i studentëve shqyrton dhe vendos për të gjitha çështjet në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve në fakultet.

Këshilli i studentëve realizon interesat e veta, lidhur me mbarëvajtjen e procesit mësimor, përmes përfaqësuesve të vet në këshillin e fakultetit. Anëtarët studentë të këshillit të fakultetit marrin pjesë në propozimin e kandidatëve për dekan.

Përfaqësuesit e studentëve të Fakultetit Juridik përveç në Këshillin e Fakultetit janë të përfaqësuar edhe në Komisionin e Studimeve.

Studentët e Universitetit të Prishtinës dhe Fakultetit Juridik janë të përfaqësuar edhe në Senatin e Universitetit të Prishtinës.

Nga viti akademik 2020/2022 nga Dekani i Fakultetit Juridik janë iniciuar dhe përkrahur (propozimet e studentëve) themelimi i disa grupeve të studentëve siç janë: Grupi i Studentëve të Ekselencës së Fakultetit Juridik, Grupi i Debatit, Grupi për realizimin e Programit “Guest Speaker”, etj., ku pjesë e tyre janë studentët e të gjitha viteve, përfshirë edhe përfaqësuesit e Këshillit Studentor (si përfaqësues të studentëve të Fakultetit Juridik).

### **17. Organizimi i Fakultetit Juridik**

Në kuptim të organizimit të brendshëm Fakulteti Juridik përbëhet nga disa struktura (organe). Struktura organizative e Fakultetit Juridik përbëhet nga:

1. Dekani;
2. Këshilli i Fakultetit;
3. Prodekanët;
4. Katedrat/Departamentet e Fakultetit (të cilat përbëhen nga personeli akademik);
5. Sekretari i Fakultetit;
6. Qendrat;
7. Komisioni i studimeve;
8. Komisioni disiplinor;
9. Administrata e Fakultetit.

## Shtojcë I:

### PYETJE TË SHPESHTA NGA STUDENTËT E FAKULTETIT JURIDIK

#### 1. Si bëhet aplikimi dhe cilat dokumente janë të nevojshme për aplikim për t'u regjistruar në Fakultetin Juridik?

Të gjithë ata/ato që aplikojnë në Fakultetin Juridik, me qëllim të fitimit të statusit të studentit/es duhet të kenë të përfunduar shkollën e mesme.

Dokumentet e nevojshme për të aplikuar në Fakultetin Juridik janë:

- Certifikatat e shkollës së mesme;
- Certifikata e testit të maturës;
- Certifikata e lindjes;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Aplikacioni për aplikim i cili shkarkohet online dhe
- Fletëpagesa.

#### 2. Si bëhet ndarja e studentëve në lëndët obligative dhe zgjedhja e profesorit të lëndës?

Në pajtim me vendimin e Këshillit të Fakultetit dhe Rregullores për SEMS, ndarja e lëndëve obligative do të bëhet varësisht nga numri i grupeve dhe profesorëve përkatës sipas shpalljes së orarit zyrtar. Për të lejuar lirinë e zgjedhjes së profesorit, studentët do të kenë mundësi që të zgjedhin profesorin përkatës deri në përmbushjen e numrit të caktuar të studentëve për atë lëndë. Rrjedhimisht, në këtë sistem do të shfrytëzohet parimi **i pari në kohë i pari në të drejtë** (primus in tempore a potior in iure). Pas përmbushjes së numrit të caktuar për grupin dhe profesorin përkatës studentët do të jenë të detyruar që të regjistrojnë lëndën tek profesori tjetër në radhë ku nuk është plotësuar numri.

#### 3. Si bëhet zgjedhja e lëndëve zgjedhore dhe të profesorit të lëndës?

Në pajtim me vendimin e Këshillit të Fakultetit dhe Rregullores për SEMS, tek zgjedhja e lëndëve zgjedhore, studentët do të kenë lirinë e zgjedhjes së lëndës në varshmëri të numrit të studentëve të regjistruar për atë vit akademik në mënyrë proporcionale më numrin e lëndëve që ofrohen për atë vit akademik. Për lëndët zgjedhore ku figurojnë më shumë se një bartës, fillimisht bëhet zgjedhja e lëndës dhe pastaj profesori përkatës sipas zgjedhjes së studentit deri në përmbushjen e numrit të caktuar. Edhe në këtë rast do të shfrytëzohet parimi **i pari në kohë i pari në të drejtë drejtë** (primus in tempore a potior in iure). Pas përmbushjes së numrit të caktuar për grupin dhe profesorin përkatës studentët do të jenë të detyruar që të regjistrojnë lëndën tek profesori tjetër në radhë ku nuk është plotësuar numri.

#### **4. Si bëhet kërkesa për vërtetim të statusit të studentit?**

- Studenti/ja lajmërohet tek zyrtari për shërbim të studentëve me ID kartelë studentore;
- Kërkesa bëhet në mënyrë verbale;
- Pas marrjes së vërtetimit nga zyrtari i shërbimit të studentëve, vërtetimi duhet të protokollohet tek zyra arkivit nga ana e studentit/es.

#### **5. Si bëhet kërkesa për nxjerrjen e transkriptës së notave?**

- Studenti/ja lajmërohet tek zyrtari për shërbim të studentëve me ID kartelë studentore;
- Kërkesa bëhet në mënyrë verbale tek zyrtari i shërbimit;
- Pas marrjes së transkriptës, ajo protokollohet tek zyra e arkivës nga ana e studentit/es.
- Për këtë kërkesë duhet të bëhet një pagesë prej 2,50 Euro në një nga bankat komerciale ose në Postën e Kosovës.

#### **6. Si bëhet regjistrimi i semestrit?**

- Studenti/ja duhet të nxjerrë fletëpagesën nga programi SEMS përmes llogarisë së tij/saj studentore;
- Pagesa bëhet në një nga bankat komerciale ose në Postën e Kosovës;
- Pas tri dite, pagesa dorëzohet në zyrën për shërbim të studentëve së bashku me fletëregjistrimin i cili nxirret nga faqja zyrtare të internetit të Universitetit të Prishtinës dhe Fakulteti Juridik.

#### **7. Si aplikohet për çertifikatë diplome?**

- Studenti/ja pasi të kaloj me sukses provimin e fundit të planprogramit në të cilin është regjistruar paraqet kërkesën në arkivën e fakultetit;
- Formulari i kërkesës për çertifikatë diplome së bashku me fletëregjistrimin tërhiqet tek zyrtari për mësim, zyra nr. 2;
- Studenti/ja duhet të bëjë një pagesë për çertifikatë diplome në një nga bankat komerciale ose Postën e Kosovës;
- Fletëpagesa nxirret përmes llogarisë individuale e studentit/es në SEMS;
- Kërkesa, së bashku me të gjitha dokumentet e cekura dorëzohet në zyrën për shërbim të studentëve.



## 8. Si aplikohet për diplomë?

- Pasi të bëhet verifikimi i notave nga ana e shërbimit për studentë, studenti/ja bën një pagesë për diplomë në njërin nga bankat komerciale ose Postën e Kosovës;
- Fletëpagesa nxirret nga llogaria individuale e studentit në SEMS. Pagesa për diplomë bëhet çdo të premte;
- Fletëpagesa dorëzohet ditën e mërkurë së bashku me dosjen e cila merret në zyrën e kartotekës;
- Për diplomë të nivelit Master nevojitet edhe përkthimi i titullit të temës së masterit;
- Dosja e kompletuar me këto dokumente dorëzohet tek zyrtari i lartë i shërbimit, zyra nr. 1.

## 9. Si bëhet paraqitja e provimit?

- Paraqitja e provimit bëhet përmes llogarisë personale të studentit/es në SEMS ku në vegzën e listës së lëndëve figurojnë lëndët të cilat studenti/ja mund t'i paraqes për t'iu nënshtruar provimit;
- Studenti/ja e nivelit master duhet të bëjnë pagesën për provim në njërin nga bankat komerciale ose Postën e Kosovës dhe të sjellë fletëpagesën në zyrën për shërbim të studentëve të nivelit master.

## 10. Cilat janë kushtet për fitimin e bursës universitare?

- Studenti/ja duhet të ketë përfunduar provimet e vitit përkatës brenda afatit të rregullt të vitit akademik (të gjitha provimet e vitit duhet të përfundojnë në shtator të atij viti akademik dhe të mos ketë vit të përsëritur);
- Të jetë student/e e rregullt;
- Nota mesatare duhet të jetë së paku 9.00.

## 11. Çka janë programet e shkëmbimit ERASMUS?

- Programet e shkëmbimit ERASMUS janë programe të BE-së të cilat i ofrohen studentëve (por edhe personelit akademik) përmes të cilave studentët kanë mundësi studimi me kohë të caktuar në një nga universitetet evropiane në kuadër të kësaj kornize;
- Sipas rregullores së UP-së për mobilitet akademik studentët, të cilët përfundojnë lëndët e caktuara me sukses në universitetet huaja në kuadër të programit ERASMUS, kanë mundësinë që të transferojnë notat e tyre në lëndët e ngjashme në fakultetin ku ata studiojnë;

- Ngjashmëria (kompatibiliteti) i lëndëve për transferim të notës duhet të jetë të paktën 70%.

## **12. Si mund të konkurroj për ERASMUS?**

- Për të fituar të drejtën për të konkuruar për programin ERASMUS, së pari Universiteti i Prishtinës duhet të nënshkruaj marrëveshje shkëmbimi në kuadër të kësaj kornize;
- Në marrëveshje caktohen kuotat e studentëve dhe fushat e studimit ku lejohet shkëmbimi i studentëve;
- Studenti duhet të plotësojë Marrëveshjen për Mësim (Learning Agreement) ku shënohen lëndët të cilat dëshiron t'i ndjekë në universitetin e huaj dhe në rubrikën tjetër duhet të shënoj lëndët të cilat janë kompatible (të paktën në masën 70%) të cilat ofrohen në Fakultetin Juridik vendor;
- Marrëveshja për Mësim i dërgohet zyrtarit për zhvillim akademik në Fakultetin Juridik i cili më pas ia përcjell Prodekanit për Çështje Mësimore për marrjen e aprovimit final;
- Informatat në lidhje me marrëveshjet në fuqi dhe validitetin e tyre në kuadër të programit ERASMUS gjenden në faqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës.

## **13. Si bëhet transferimi i notës (vlerësimit) të marrë në kuadër të programit ERASMUS?**

- Marrëveshja për Mësim e nënshkruar nga Prodekani për Çështje Mësimore është e mjaftueshme për t'i garantuar studentit transferimin e notës në Fakultetin Juridik;
- Studenti duhet të siguroj transkriptin origjinal të vlerësimit nga universiteti ku ka përfunduar programin ERASMUS;
- Në rastet kur nuk është e qartë natyra e vlerësimit atëherë studentit duhet të siguroj interpretim zyrtar të vlerësimit nga fakulteti ku ka përfunduar programin (në shumë raste ky interpretim ofrohet në transkriptën e notave të lëshuar nga fakulteti);
- Studenti duhet të paraqes provimin sipas kompatibilitetit të lëndëve përkatëse dhe sipas mundësisë së paraqitjes së tyre në mënyrë të rregullt;
- Vendimin përfundimtar për bartje të notës e merr komisioni i studimeve të Fakultetit Juridik;
- Kërkesa për njohje të notës bëhet pas kthimit të studentit/es nga mobiliteti;
- Profesori i lëndës e shënon notën në SEMS.

## **14. Cilat janë kushtet për regjistrimin e vitit akademik?**

- Viti i parë akademik regjistrohet me rastin e pranimit të studentit në studimet përkatëse;

- Për të regjistruar vitin e dytë studenti duhet të ketë përfunduar së paku 70% të provimeve në vitin paraprak;
- Për të regjistruar vitin e tretë studenti duhet të ketë përfunduar së paku 60% të provimeve në vitin paraprak;
- Për të regjistruar vitin e katërt, studenti duhet të ketë përfunduar së paku 40% të vitin paraprak;
- Çdo fillimvit akademik, Senati i Universitetit të Prishtinës i rishqyrton kriteret e regjistrimit të vitit akademik dhe fitimin e kushtit për vitin përkatës.

#### **15. Ku duhet t'i ndjekë ligjëratat dhe si caktohet grupi?**

- Sipas rregullores së SEMS studenti/ja duhet t'i ndjekë ligjëratat sipas grupit të paracaktuar nga programi elektronik SEMS;
- Studenti nuk mund të ndërroj grupin e paracaktuar;
- Orari i ligjëratave shpallet online në web faqe dhe në tabelën e shpalljeve;
- Studenti/ja mund të paraqes provimin në lëndën përkatëse vetëm tek profesori i lëndës ku ka ndjekur ligjëratat.

#### **16. Cila është koha e regjistrimit të semestrit?**

- Koha e rregullt e regjistrimit të semestrit dimëror është 1-15 tetor të secilit vit akademik;
- Koha e rregullt e regjistrimit të semestrit veror është 15 shkurt – 1 mars të secilit vit akademik.

#### **17. Si bëhet kërkesa për pyetje me komision?**

- Në rastet kur studenti/ja dështon të përfundoj me sukses provimin edhe pas herës së tretë të nënshtrimit të testimit në atë provim, studenti/ja duke arsyetuar kërkesën e tij mund të kërkojë nga dekani që të autorizoj formimin e një komisioni për të pyetur studentin/en e cila ka parashtuar kërkesën;
- Dekani vendos sipas arsyesimit dhe fakteve të ofruara.

#### **18. Si caktohet orari i konsultimeve me profesor?**

- Studenti/ja njoftohet për orarin e konsultimeve në fillim të semestrit për secilën lëndë nga ana e Profesorit të lëndës;
- Profesori, shënon në syllabus të lëndës përkatëse orarin dhe lokacionin e konsultimeve;
- Konsultimet për provim nuk janë obligative për t'u mbajtur, por studentët kanë të drejtë të kërkojnë sqarime për rezultatin e provimit përkatës.

## 19. Si aplikohet për diplomë duplikat?

- I/e diplomuara duhet të bëjë shpalljen publike për pavlefshmëri të diplomës paraprake në njërin nga gazetat ditore të Kosovës;
- Një pagesë prej 25.00 Euro duhet të bëhet në njërin nga bankat komerciale ose Postën e Kosovës;
- Fletëpagesa nxirret nga faqja zyrtare e Universitetit të Prishtinës;
- I/e diplomuara e deponon fletëpagesën së bashku me shpalljen e pavlefshmërisë të diplomës paraprake si dhe kopjen e letërnjoftimit valid në Administratën Qendrore të Universitetit të Prishtinës e cila ndodhet në objektin e Bibliotekës Universitare jashtë Fakultetit Juridik.

## 20. Si bëhet kërkesa për nxjerrjen e transkriptit të notave për të diplomuarit?

- Studenti/ja bën një pagesë për transkriptë të notave në njërin nga bankat komerciale ose Postën e Kosovës;
- Fletëpagesa nxirret nga faqja zyrtare e Universitetit të Prishtinës;
- Kërkesa për transkriptë bëhet me shkrim të cilën e përpilon studenti/es duke ia drejtuar sektorit të arkivës së Fakultetit Juridik;
- Kërkesa, së bashku me dokumentet e cekura deponohet në arkivën e fakultetit (zyra nr. 4).

## 21. Si bëhet kërkesa për nxjerrjen e shtojcës së diplomës për të diplomuarit nga Presheva, Medvegja e Bujanoci?

- Kërkesa për shtojcë bëhet me shkrim të cilën e përpilon studenti/ja duke ia drejtuar zyrtarit të lartë të shërbimit të studentëve të fakultetit;
- Së bashku me kërkesë, studenti/ja dorëzon edhe një kopje të diplomës tek zyrtari i lartë për shërbim të studentëve (zyra nr. 1).

## 22. Si bëhet ç'regjistrimi nga studimet?

- Studenti/ja e bën një kërkesë për ç'regjistrim duke ia drejtuar dekanit;
- Kërkesën e përpilon studenti individualisht duke ofruar arsyet për lejimin e ç'regjistrimit;
- Së bashku me kërkesën studenti/ja duhet të deponojë një kopje të ID kartelës studentore dhe një kopje të letërnjoftimit valid;
- Kërkesa deponohet në zyrën e arkivës së Fakultetit Juridik.

### **23. Si bëhet pagesa për semestër, transkriptë të notave, çertifikatë diplome, diplomë?**

- Fletëpagesa nxirret nga faqja zyrtare e Universitetit të Prishtinës;
- Pagesa bëhet në njërin nga bankat komerciale ose Postën e Kosovës dhe dorëzohet pas tre ditëve të pagesës tek zyra e shërbimit për studentë.

### **24. A mund të bëhet ndryshimi i lëndëve zgjedhore pasi që është bërë zgjedhja e tyre nga ana e studentit/es?**

- Studenti/ja nuk ka të drejtë të ndryshojë lëndët zgjedhore pasi që ai me vullnet t'i ketë zgjedhur ato lëndë paraprakisht.

### **25. Sa kredi ECTS akumulohet gjatë studimeve themelore, master dhe doktoraturë?**

- Pas përfundimit me sukses të studimeve themelore (baçelor) studenti akumulon gjithësejt 240 ECTS kredi;
- Pas përfundimit me sukses të studimeve master studenti akumulon gjithësejt 60 ECTS kredi;
- Pas përfundimit me sukses të studimeve të doktoratës studenti akumulon gjithësejt 180 ECTS kredi.

### **26. Si bëhet pajisja me ID kartelë studentore?**

- Pas pranimit me sukses në fakultet (baçelor, master dhe doktoratë) studenti/ja regjistrohet në administratën qendrore dhe bëhet fotografimi për ID;
- Vendi dhe koha se kur duhet të paraqiten në administratën qendrore parashihet në konkurs për regjistrim të studimeve përkatëse;
- Nëse studenti humbë ID kartelën e lëshuar fillimisht nga Universitetit, ai/ajo mund të aplikojë për ID kartelë tjetër dhe është i obliguar të bëjë pagesën prej 5 (pesë) Euro.

### **27. Si të qasemi në SEMS?**

- Qasja në SEMS (Sistemi Elektronik për Menaxhimin me Studentë) bëhet duke u qasur në vegën: <https://studenti.uni-pr.edu/>;
- Pasi studenti/ja të kyçet në këtë vegzë hapet dritarja ku kërkohet të shënohet numri i ID-së dhe fjalëkalimi;
- Fjalëkalimi për herë të parë për secilin student është numri personal i letërnjoftimit dhe pasi të kyçet për herë të parë pastaj i ofrohet mundësia e vënies së fjalëkalimit të ri;
- Rekomandohet që secili student të ndryshoj fjalëkalimin me rastin e qasjes së parë në llogarinë e tij/saj personale në SEMS për arsye sigurie.

## **28. Cili është orari i punës me palë i zyrës së shërbimit për studentë?**

- E hënë 10:00 – 12:00 dhe 13:00-15:00;
- E martë 10:00 – 12:00 dhe 13:00-15:00;
- E mërkurë 10:00 – 12:00 dhe 13:00-15:00;
- E premte 10:00 – 12:00 dhe 13:00-15:00;
- Të enjten shërbimi i studentëve nuk është i hapur për punë me palë.

## **29. Ku gjendet administrata qendrore?**

- Administrata Qendrore gjendet në objektin e Bibliotekës Universitare.

## **30. Në cilën kohë zgjedhën lëndët zgjedhore?**

- Studenti/ja duhet të përcaktohet për lëndët zgjedhore në javën e parë të çdo semestri;
- Studenti mund të zgjedhë vetëm një nga lëndët e ofruara për semestër.

## **31. Ku mund të gjëjmë orarin e provimeve, ligjëratave dhe silabusët e lëndëve?**

- Orari i provimeve, ligjëratave dhe silabusët e lëndëve postohen në faqen zyrtare të Fakultetit Juridik në këtë vegzë <https://juridiku.uni-pr.edu/page.aspx?id=1,46>

## **32. Si bëhet refuzimi notës?**

- Secili student ka të drejtën që brenda 72 orëve të notimit të studentit të refuzojë notën me të cilën është shënuar suksesi i tij/saj në SEMS;
- Studenti duhet të përcjellë llogarinë e tij/saj personale në SEMS pas marrjes së rezultatit në mënyrë të rregullt me qëllim të shfrytëzimit të të drejtave të tij/saj;
- Pas kalimit të afatit prej 72 orëve nuk mund të bëhet refuzimi i notës.

## **33. Sa është kohëzgjatja maksimale e studimeve?**

- Studenti mund të zgjasë studimet e tij deri në maksimum sa dyfishi i studimeve në atë program ku është i regjistruar;
- Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një apo dy vite. Vendimin e merr këshilli i njësisë akademike.

### **34. Cilat janë organet që i përfaqësojnë interesat e studentëve në kuadër të Universitetit?**

- Parlamenti i studentëve në nivel të Universitetit dhe
- Këshilli i studentëve në nivel të njësisë akademike

### **35. Informatat mbi lokacionin e sallave, bibliotekave, zyrat për shërbim të studentëve kabineteve, dekanatit etj.**

- Të gjitha informatat në lidhje me këtë çështje ndodhen në tabelat njoftuese brenda fakultetit.

### **36. Si aplikohet për bursë universitare?**

Studenti/ja për të aplikuar për bursë universitare student/ja duhet të ketë dokumentacionin si në vijim: vërtetimin që është student i rregullt; të ketë përfunduar vitin në afatin e shtatorit; nota mesatare si më sipër. Aplikimi bëhet online dhe kërkesa shkarkohet nga web faqja e Universitetit të Prishtinës. Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në zyrën e shërbimit të studentëve të Fakultetit Juridik. Pas shpalljes së listës së përfituesve të bursës, studentët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh.

### **37. Çka ndodhë nëse humb ID studentore?**

Me rastin e humbjes së ID-së studentore, student/ja duhet të shpallë të njëjtën të pavlefshme, t'a lajmëroj në organet kompetente si të humbur. Studenti/ja e njofton administratën e Fakultetit Juridik, pasi të ketë shpallur publikisht të humbur ID kartelën e tij/saj dhe i njëjti për prodhimin e kartelës së re duhet të aplikojë në administratën qendrore. Administrata Qendrore, pas prodhimit të ID kartelës së studentit/es njofton njësinë akademike, respektivisht Fakultetin Juridik, se kartela përkatëse e studentit/es është gati.

### **38. Vlerësimi i profesorëve në SEMS?**

Në fund të semestrit përkatës, respektivisht para hapjes së afatit për paraqitjen e provimeve, studentët duhet të bëjnë vlerësimin e profesorëve në SEMS. Studentët do të njoftohen nga SEMS se nuk mund të paraqesin provimin e lëndës që e kanë dëgjuar në atë semestër, në rast se nuk e bëjnë vlerësimin e profesorit të lëndës. Vlerësimin mund t'a bëjnë vetëm studentët të cilët kanë regjistruar lëndën dhe vlerësimi mund të bëhet vetëm për profesorin tek i/e cili/a studentët e kanë regjistruar lëndën.

### **39. Lokacioni dhe mënyra e pajisjes më ID?**

Pas kryerjes së regjistrimit të studentëve në vitin e parë, administrata qendrore do të njoftoj njësinë akademike për prodhimin e ID kartelave të studentëve. Më së largu 2 javë pas fillimit të vitit akademik, Fakulteti Juridik do të organizojë shpërndarjen e ID kartelave. Orari i shpërndarjes së ID kartelave do të publikohet nga Fakulteti Juridik dhe person kontaktues për këtë proces do të jetë zyrtari për mësim në Fakultetin Juridik.

### **40. Cilat janë sallat e Fakultetit Juridik?**

Sallat e Fakultetit Juridik, në të cilat mbahen ligjëratat dhe ushtrimet janë:

- A1-Amfiteatri i madh;
- A2-Amfiteatri i vogël;
- A3-Salla kati I;
- A4-Salla kati I;
- S1,S2,S3,S4-Salla kati III;
- D1,D2,D3,D4-Salla kati IV;
- S5-Gjyikatorja.

### **41. Cilat janë email-at kontaktues të Fakultetit Juridik?**

Me qëllim të komunikimit dhe të parashtrimit të kërkesave të tyre, studentët e Fakultetit Juridik mund të përdorin si kontakt email-at si në vijim:

- Email i Fakultetit Juridik: [juridiku@uni-pr.edu](mailto:juridiku@uni-pr.edu)
- Email i Zyrës së Dekanit: [zyraedekanit.juridik@uni-pr.edu](mailto:zyraedekanit.juridik@uni-pr.edu)
- Email i zyrës së IT-së që mund të përdoret për problemet që shfaqen me SEMS: [it.juridik@uni-pr.edu](mailto:it.juridik@uni-pr.edu)

### **Sqarim lidhur me pyetjet e shpeshta:**

\* Pagesat të cilat nuk janë specifikuar këtu janë të shënuara në fletëpage sat përkatëse me rastin e nxjerrjes së tyre nga SEMS.

\*\* Informatat e lartshënuara vlejnjë për nivelin baçelor dhe master përveç nëse është përcaktuar ndryse.



Shtojcë II:

PROGRAMI BAÇELOR-LËNDËT OBLIGATIVE DHE ZGJEDHORE: 2017-2023

Viti I

Semestri I			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	<b>Fillet e së drejtës</b>	3	2	8
2.	O	<b>Historia e Institucioneve shtetërore dhe juridike</b>	3	1	6
3.	O	<b>Ekonomia</b>	2	1	6
4.	O	<b>Gjuhë e huaj</b>	0	2	5
5.	Z	E drejta e konkurrencës	2	1	5
6.	Z	Sociologjia e së drejtës	2	1	5
7.	Z	Bazat e sistemit gjyqësor	2	1	5
8.	Z	Informatikë ( programet e reja)	2	1	5

Semestri II

1.	O	<b>E drejta Romake</b>	3	1	7
2.	O	<b>E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut</b>	2	2	7
3.	O	<b>Sociologjia</b>	2	1	6
4.	O	<b>Gjuhë e huaj</b>	2	1	5
5.	Z	E drejta parlamentare	2	1	5
6.	Z	Retorika dhe shprehja juridike	2	1	5
7.	Z	Historia e shtetit dhe e së drejtës shqiptare	2	1	5

## Viti II

Semestri I			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1	O	<b>E drejta kushtetuese</b>	3	1	7
2	O	<b>E drejta penale</b>	3	1	7
3	O	<b>E drejta civile</b>	3	1	7
4	O	<b>E drejta administrative</b>	2	1	7
5	Z	Konsumi dhe të drejtat e konsumatorëve	2	1	5
6	Z	E drejta e kadastrave	2	1	5
7	Z	Klinika juridike nga e drejta familjare dhe trashëgimore	2	0	5
8	Z	Komunikimi masiv dhe e drejta	2	1	5
9	Z	Politika kriminale	2	1	5

## Semestri II

1	O	<b>Politika ekonomike</b>	2	1	4
2	O	<b>Kriminalistika</b>	2	1	6
3	O	<b>E drejta familjare dhe trashëgimore</b>	2	1	6
4	O	<b>Organizatat ndërkombëtare</b>	2	1	6
5	Z	Gjyqësia kushtetuese	2	1	5
6	Z	Kundërvajtjet në lëmin penal	2	1	5
7	Z	Klinika juridike civile	2	0	5

### Viti III

Semestri I			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1	O	<b>E drejta ndërkombëtare publike</b>	3	1	7
2	O	<b>E drejta e detyrimeve</b>	3	1	6
3	O	<b>E drejta e procedurës penale</b>	2	1	6
4	O	<b>E drejta ndërkombëtare private</b>	3	2	6
5	Z	Krimi i organizuar	2	1	5
6	Z	Shkathësitë praktike gjyqësore	2	1	5
7	Z	Taktika kriminalistike	2	1	5
8	Z	E drejta e sigurimit social ndërkombëtar	2	1	5
9	Z	Vet - Administrimi lokal	2	1	5
10	Z	E drejta bankare	2	1	5
11	Z	Arbitrazhi	2	1	5
12	Z	Siguria kolektive ndërkombëtare dhe NATO	2	1	5

### Semestri II

1	O	<b>E drejta e punës</b>	3	1	7
2	O	<b>E drejta e unionit evropian</b>	3	2	6
3	O	<b>Procedura administrative</b>	2	1	6
4	O	<b>Financat dhe e drejta financiare</b>	3	0	6
5	Z	Mjekësia ligjore	2	1	5
6	Z	Klinikat juridike penale	2	0	5
7	Z	Terrorizmi	2	1	5
8	Z	Hulumtimi dhe shkrimi ligjor	2	1	5
9	Z	Klinka Juridike Financiare	2	0	5

## Viti IV

Semestri I			Orë/javë		
Nr.	O/Z	Lëndët	L	U	ECTS
1.	O	E drejta procedurale civile	3	1	7
		Metodologjia dhe shkrimi ligjor			
2.	O		2	1	6
3.	O	Kriminalogji me Penologji	3	1	6
4.	O	E drejta tregare	2	1	6
5.	Z	E drejta tregtare ndërkombëtare	2	1	5
6.	Z	Etika ligjore dhe profesionale	2	1	5
7.	Z	E drejta e sigurimeve	2	1	5
8.	Z	Analiza ekonomike e së drejtës	2	1	5
9.	Z	E drejta ndërkombëtare e punës	2	1	5

## Semestri II (Modulet) Administrativ- Kushtetues

1	O	E drejta kushtetuese e Republikës së Kosovës	3	2	8
2	O	E drejta administrative – pjesa e posaçme	3	2	8
3	O	Filozofia e së drejtës	3	1	7
4	O	E drejta sociale	3	1	7

## Moduli i shkencave penale juridike

1	O	E drejta penale – pjesa e posaçme	3	2	8
2	O	E drejta procedurale penale - pjesa e posaçme	3	2	8
3	O	Viktimologjia	3	1	7
4	O	E drejta penale ndërkombëtare	3	1	7

Moduli i shkencave civile juridike

1	O	<b>E drejta sendore (pronësia)</b>	3	2	8
2	O	<b>E drejta procedurale civile-pjesa e posaçme</b>	3	2	8
3	O	<b>E drejta kontraktore</b>	3	1	7
4	O	<b>E drejta e pronësisë intelektuale</b>	3	1	7

Moduli i shkencave ndërkombëtare juridike

1	O	<b>E drejta ndërkombëtare private konvencionale</b>	3	2	8
2	O	<b>Teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare</b>	3	2	8
3	O	<b>E drejta ndërkombëtare humanitare</b>	3	1	7
4	O	<b>E drejta diplomatike dhe konsullore</b>	3	1	7

Moduli i shkencave financiare juridike

1	O	<b>Institucionet financiare ndërkombëtare</b>	3	2	8
2	O	<b>E drejta ndërkombëtare ekonomike</b>	3	2	8
3	O	<b>E drejta tatimore dhe buxhetore</b>	3	1	7
4	O	<b>Qeverisja e korporatave</b>	3	1	7

